

Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup

KOMITETI I  
**HELSINKIT**  
PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
I REPUBLIKES SE  
MAQEDONSE

RRJETA

23

PËRMBLEDHJA E REZYMEVE NGA

HULUMTIMI I GRANTISTËVE

TË PROJEKTIT **RRJETI 23+**



PËRMBLEDHJA E REZYMEVE NGA

HULUMTIMI I GRANTISTËVE

TË PROJEKTIT **RRJETI 23+**

# RRJETA

# 23

Titulli i publikimit:

Përmbledhja e rezymeve nga hulumtimi i grantistëve të projektit RRJETI 23+

Botues:

Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

Përpunimi grafik dhe shtypi:

Relativ

Përktheu:

Blerina Starova Zlatku

---

Ky publikim është bërë i mundur nga Bashkimi Evropian dhe nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze në Beograd, në kuadër të projektit Rrjeti 23+, i implementuar nga Instituti për politikë evropiane – Shkup dhe Komiteti Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk i pasqyron qëndrimet e donatorëve.

## Përmbajtja:

<b>Aksioni i femrave</b>   Drejt panoptikonit qytetar: Baraspeshë më e mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës për ndjekjen e komunikimeve.....	5
<b>ZIP Institut</b>   Kush punëson komuna apo partia?.....	8
<b>Shoqata e punonjësve financiar të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike</b>   Burimet e financimit, lartësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor.....	9
<b>Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim</b>   A do të ketë “bilbilfryrës” në universitete? Mundësitë e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe parandalimin e korrupsionit në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë.....	12
<b>Koalicioni të gjithë për gjykim të drejtë</b>   Monitorimi i implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në Gjykatën Themelore Shkup I dhe Shkup II.....	15
<b>Multikultura</b>   Ndihma juridike falas – sfidat dhe zgjidhjet.....	18
<b>Hapni dritaret</b>   Aksesit dhe inkluziviteti i gjykatave në Maqedoni.....	20
<b>Shoqata Qendra për Strategji dhe Zhvillim PAKTIS</b>   Analizë e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit.....	22
<b>Këshilli për parandalimin e delikuencës së të miturve – KPDM</b>   Analizë e zbatimit të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit.....	24



## Aksioni i femrave | Drejt panoptikonit qytetar: Baraspeshë më e mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës për ndjekjen e komunikimeve<sup>1</sup>

### Qëllimi dhe hyrja në hulumtim

Ky studim mbi politikën publike ka për qëllim të inicioj fuqizimin e respektimit të së drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes të të dhënave personale gjatë komunikimeve elektronike në Republikën e Maqedonisë, përmes prezantimit dhe përfaqësimit të rekomandimeve për ndryshimin e kornizës juridike dhe mbikëqyrëse në bazë të së drejtës së BE-së dhe praktikave më të mira nga vendet-anëtare të Bashkimit, në drejtim të kufizimit të mundësisë për ndjekje masive dhe joselektive të komunikimeve, metatëdhënave dhe distancimit të qartë të kompetencave të shërbimeve inteligjente dhe organeve hetuese.

Publikimi i “bombave” politike në vitin 2015, të cilat e vunë në dukje ndjekjen jolegale të komunikimeve telefonike të elitave politike dhe biznes-elitave, mediave dhe aktivistëve qytetarë, ndodhi për herë të dytë nga pavarësia e Maqedonisë – pas aferës “Golemoto uvo” (“Veshi i madh”) në vitin 2000 – të zbulohet përgjimi jolegal masiv, me ç’rast është cenuar privatësia, mbrojtja e të dhënave personale dhe liria e të shprehurit. Skandalet e kësaj natyre i vënë në dukje keqpërdorimet serioze të sistemit shtetëror për ndjekjen e komunikimeve, më konkretisht, pajisja dhe personeli i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim. Komisioni Evropian shprehu shqetësime në raportet për Maqedoninë, të vitit 2015 dhe 2016, në lidhje me ndjekjen masive të komunikimeve elektronike, ndërkaq në Prioritetit Urgjent të Reformave theksoi reforma serioze që duhet të ndërmerren për tejkalimin e mangësive në kornizën ligjore për ndjekjen e komunikimeve dhe implementimin e tyre.

Ligji për komunikime elektronike (LKE) në vitin 2014 përfshiu risi në ndjekjen e përmbajtjes së komunikimeve, si dhe në mbajtjen masive të të dhënave sa i përket komunikimit të qytetarëve. Ligji mundësoi që Ministria e Punëve të Brendshme të ketë akses të drejtpërdrejt dhe të pakufizuar deri te përmbajtja e të gjitha komunikimeve elektronike të të gjithë qytetarëve. Përveç kësaj, u inkorporua obligimi që të gjithë shfrytëzuesit e telefonisë dhe internetit t’i mbajnë një vit të ashtuquajturat “metatëdhëna” për të gjithë shfrytëzuesit e tyre. Dispozitat, në lidhje me mbajtjen masive të të dhënave, u arsyetuan si transponim të Direktivës 2006/24/KE, e cila u anulua nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë menjëherë pas miratimit të LKE të ri. Megjithatë, Republika e Maqedonisë akoma nuk ka ndërmarrë masa përkatëse, me qëllim që t’i tejkaloj sfidat serioze të imponuara nga situata e këtillë. Duke i pasur parasysh sfidat e detektuara, autorët propozojnë një sërë rekomandimesh të cilat duhet të mundësojnë në vend të sistemit panoptikon – ku qytetarët janë të frikësuar meqë janë në vëzhgim të vazhdueshëm nga pushteti – në Maqedoni të ndërtohet sistemi – panoptikon qytetar në të cilin transparenca e determinon llogaridhënien e bartësve të pushtetit ndaj qytetarëve. Rekomandimet, në mënyrë të detajuar, janë prezantuar me titull përkatës në këtë studim, ndërkaq në vazhdim, në pika të shkurtra, janë dhënë rekomandimet kryesore.

<sup>1</sup> [http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Kon-gragjanski-panoptikon-ramnoteza-pomegju-sledenje-na-komunikaciite-i-privatnosta\\_MK.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Kon-gragjanski-panoptikon-ramnoteza-pomegju-sledenje-na-komunikaciite-i-privatnosta_MK.pdf)

## Rekomandime

>>>Të shfuqizohen nenet 176–178 të Ligjit për komunikime elektronike të cilët e përcaktojnë mbajtjen e metatëdhënave për shkak të shfuqizimit të Direktivës 2006/24/KE nga ana e Gjykatës Evropiane, Direktivë e cila është transponuar në këtë Ligj. Ndjekja dhe këqyrja e metatëdhënave për komunikime elektronike të përfshihet me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve.

>>>Të rishikohet arsyeshmëria që të lejohet ndjekja e komunikimeve për një spektër kaq të gjerë të veprave penale, në bazë të vlerësimit nëse cenimi i privatësisë është proporcional me peshën e veprës penale për të cilën bëhet fjalë dhe provat që pritet të grumbullohen me masa të veçanta hetuese, përkatësisht me ndjekjen e komunikimeve.

>>>Të pamundësohet qasja e drejtpërdrejt deri te përmbajtja e komunikimeve nga ana e shërbimeve, përkatësisht organet kompetente paraprakisht duhet ta njoftojnë operatorin dhe t'u dorëzojnë urdhër gjyqësor për ndjekje, dhe pastaj operatori t'ua mundësoj qasjen deri te komunikimet e personave të përfshirë.

>>>Në kërkesën për ndjekjen e komunikimeve duhet të potencohet dhe arsyetohet dyshimi i bazuar për kryerje të mundshme ose për vepër tanimë të kryer penale, dhe jo vetëm bazë për dyshime si shkallë shumë e ulët e dyshimit.

>>>Të inkorporohet edhe një palë në procedurën e aprovimit të ndjekjes së komunikimeve e cila do t'i përfaqësoj interesat e personave, komunikimet e të cilëve propozohet të ndiqen (për shembull, panel i ekspertëve, përfaqësues i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose përfaqësues i Avokatit të Popullit). Kjo palë ka të drejtë të paraqes kundërshtim ndaj kërkesave për ndjekjen e komunikimeve, si dhe urdhrave për ndjekjen e komunikimeve nëse konsideron se në mënyrë të paarsyeshme do të cenohet privatësia dhe të dhënat personale të qytetarëve.

>>>Të rishikohet arsyeshmëria e afateve të përcaktuara maksimalisht të gjata për ndjekjen e komunikimeve.

>>>Të distancohet me ligj kompetenca dhe aktet normative për ndjekjen e komunikimeve gjatë hetimeve penale, prej atyre me karakter sigurie dhe inteligjence.

>>>Të fuqizohet kontrolli i brendshëm i MPB që të ushtroj kontroll edhe ndaj rasteve në të cilat është keqpërdorur autorizimi për ndjekjen e komunikimeve.

>>>Nëse me ndjekjen e komunikimeve sigurohen informacione të cilat implikojnë persona të tjerë në vepra penale, ose me të cilat përcaktohen bazat për vepra tjera penale prej atyre për të cilat ka të bëjë urdhri ekzistues për ndjekjen e komunikimeve, të nevojitet lëshimi i urdhrit të ri nga gjyqtari që të vazhdoj ndjekja e komunikimeve dhe regjistrimet e këtyre komunikimeve të mund të përdoren në gjyq.

>>>Të parashikohet kujdes për kategoritë e veçanta të të dhënave personale (të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale), përkatësisht gjatë ndjekjes së komunikimeve të përjashtohen ose shlyhen deklaratimet në lidhje me këto të dhëna.

>>>Të inkorporohet obligimi palët e prekura të njoftohen për masat e posaçme hetuese pas ndërprerjes së tyre, përveç kur mund të dëshkohet se kjo mund të çoj deri në pengimin ose prejudikimin e ndjekjes penale.

>>>Të inkorporohen mekanizma juridikë efektivë të cilët mund të praktikohen në rastet kur një person i caktuar konsideron se me ndjekjen e komunikimeve i janë cenuar të drejtat nga ana e organeve kompetente. Organizatat relevante joprofitabile të kenë të drejtë ligjore të mund të paraqesin kundërshtime dhe t'i përfaqësojnë personat e prekur nga ndjekja e komunikimeve.

>>>Të fuqizohet dispozitat ligjore për sigurinë e të dhënave nga ndjekja e komunikimeve, si dhe për shkatërrimin e tyre në rastet kur më nuk janë të nevojshme për qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

>>>Të sigurohet mundësia që mbikëqyrje të paparalajmëruar të ketë çdo anëtar i komisioneve kompetente të Kuvendit, të shoqëruar me persona profesionistë të komisioneve, me ç'rast do të kenë akses edhe deri te të dhënat e agreguara për ndjekje, si dhe deri te emrat e personave dhe bazat sipas të cilave ndiqen. Përveç kësaj, të miratohen akte normative që do të sigurojnë zbatim efikas të procedurës për posedimin e certifikatës së sigurisë për anëtarët e komisioneve mbikëqyrëse të Kuvendit.

>>>Të inkorporohet edhe komision qytetar për mbikëqyrje të ndjekjes së komunikimeve, të cilin do ta emëroj Kuvendi nga ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.


>>>Të zgjerohet obligimi për njoftim lidhur me kërkesat dhe urdhrat për ndjekjen e komunikimeve edhe të gjykatave edhe të operatorëve të telekomunikacionit. Raportet e prokurorit publik t'i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara, përfshirë këtu edhe shpenzimet dhe arsyetimin në rastet kur masat nuk i kanë dhënë rezultatet e pritshme, ndërkaj të publikohen më së voni deri në fund të muajit shkurt të vitit rrjedhës për vitin paraprak. Raportet të përmbajnë edhe pasqyrën e kërkesave të pranuar, të modifikuara ose të hedhura poshtë për ndjekjen e komunikimeve, numrin e lëndëve të ndjekura të veprave penale, numrin e kërkesave për sigurimin e metatëdhënave nga provajderë të huaj të shërbimeve të internetit, numrin e regjistrimeve të shkatërruara nga masat e posaçme hetuese.

>>>Ofruesit e shërbimeve elektronike të komunikimit të kenë obligim për dizajnin, në lidhje me privatësinë, përkatësisht masat teknike dhe organizative, të cilat sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikohen qysh gjatë dizajnit të sistemit dhe jo më pas. Organet kompetente të kryejnë kontrolle të rregullta tek operatorët në lidhje me aksesin dhe përpunimin e të dhënave të komunikimeve dhe të dhënave për lokacionin e parapaguesve.

>>>Në ligjin për ndjekjen e komunikimeve të inkorporohen dispozita ndëshkuese për organet kompetente dhe për personat përgjegjës në këto organe.

>>>Të zbatohet fushatë për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve sa u përket rreziqeve gjatë komunikimeve elektronike, si dhe sa u përket të drejtave të tyre për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale gjatë komunikimit.

>>>Të përforcohet profesionalizmi dhe etika tek prokurorët publikë, gjyqtarët, si dhe të sigurohet mbështetje e jashtme për implementimin e standardeve, si dhe për trajnime dhe specializime të prokurorëve dhe gjyqtarëve në fushën e ndjekjes së komunikimeve, privatësisë dhe mbrojtjes të të dhënave personale.



## ZIP Instituti | Kush punëson komuna apo partia?<sup>2</sup>

### Konstatimet dhe rekomandimet kryesore

Hulumtimi ynë, analiza e të dhënave, analiza e intervistave dhe fokus grupit e pasqyrojnë fotografinë e gjendjes momentale sa u përket punësimeve me motive politike, përkatësisht punësimeve me motive partiake në komunat e synuara, mbi bazë të të cilave i prezantojmë rekomandimet tona. Megjithatë, duam të nënvizojmë se duhet të merren parasysh edhe proceset e luftës kundër korrupsionit dhe praktikave korruptive, siç janë (a) politizimi i përgjithshëm i administratës në Republikën e Maqedonisë, (b) shkalla e lartë e papunësisë, (c) shkalla tejet e lartë e të punësuarve në administratën publike dhe (ç) ndërgjegjësimi qytetar për problemet e kësaj natyre.

Sipas konstatimeve nga ky hulumtim, mund të konkludojmë se ekzistojnë punësime politikisht të motivuara në nivel komunal. Edhe pse paradoksalisht e njëjta mohohet nga ana e komunave, megjithatë ekziston përmirësim serioz i situatës nga reforma e kornizës juridike e cila i administron punësimet në sektorin publik, ritmi i avashtë i reformave, si dhe centralizimi i strukturave shtetërore kontribuojnë në ngadalësimin e progresit lidhur me këtë çështje.

Në vet procedurën e punësimit nuk ka fleksibilitet, e njëjta është e gjatë dhe tepër formale. U jepet përparësi personave të cilët tanimë janë në marrëdhënie pune si nëpunës administrativë, më së shumti për shkak të provimit të dhënë për nëpunës administrativë.

Edhe pse centralizimi i administrimit të procesit të punësimit nga ana e Agjencisë për Administratë është një hap në drejtim të vërtetë, megjithatë ka akoma hapësirë për përmirësimin e kësaj procedure.

Në një sistem relativisht të vogël, siç është sistemi i njërive të vetëqeverisjes lokale, ndonjëherë është e pamundur të shmanget çështja e përcaktimit politik ose partiak të ndonjë personi.

Megjithatë, punësimi skajshëm i lartë në administratën publike, krizat politike, si dhe stabiliteti i punës në sektorin publik në mënyrë plotësuese kontribuon në dëshirën për t'u punësuar në administratën publike. Së këtejmi, gjatë gjetjes së punës në administratë, njerëzit në mënyrë plotësuese mbështeten tek njohurit e tyre, lidhjet dhe koneksionet jashtë procedurave të përcaktuara përkatëse.

<sup>2</sup> Analiza është e aksesshme në: <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Koj-vrabotuva,-opshinata-ili-partijata.pdf>



## Shoqata e punonjësve financiar të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike | Burimet e financimit, lartësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor <sup>3</sup>

### Konstatimet dhe rekomandimet kryesore

Analiza paraprake, informacionet të cilat i siguroi ekipi projektues me analizën e akteve ekzistuese, informacionet dhe ngjashëm, si dhe konstatimet nga bisedat me kryetarin e KBGJ dhe kryetarët e gjykatave të zgjedhura në RM, si dhe komentet dhe propozimet që u dhanë nga përfaqësuesit e gjykatave gjatë prezantimit të draft-konstatimeve nga ky hulumtim, i vënë në dukje vlerësimet e përmbledhura në vijim në lidhje me gjendjet dhe problemet me të cilat ballafaqohen gjykatat në pjesën e mjeteve të nevojshme financiare dhe në realizimin e menaxhmentit të tyre financiar:

1. Me Kushtetutën e RM është përcaktuar ndarja e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Megjithatë, procesi ekzistues i përcaktimit të buxhetit për pushtetin gjyqësor e devalvon pavarësinë e gjyqësorit përmes inkorporimit të kufizimeve operative buxhetore të buxhetit gjyqësor, krahas shumës së përcaktuar ligjore në nivel vjetor të buxhetit gjyqësor. Me fjalë të tjera, vlerësimet fillestare të të ardhurave dhe shpenzimeve nga buxheti shtetit, të dedikuara për gjyqësorin, i përcakton Qeveria e RM-së me propozim të Ministrisë së Financave. Kjo nënkupton se në fazën e miratimit të Buxhetit të RM-së për vitin e ardhshëm, Kuvendi i RM-së nuk ka ose ka mundësi shumë të vogla për ndryshimin e Buxhetit (në këtë rast për rritjen, përkatësisht përcaktimin e shumës së përcaktuar me ligj të pjesës së dedikuar për gjyqësorin). Ky është njëri nga shkaqet më të rëndësishme se pse buxheti republikan për gjyqësorin në 4-5 vitet e kaluara nuk e arrin lartësinë e përcaktuar me Ligjin për buxhetin gjyqësor, ndërkaq nga ana tjetër gjykatave në mënyrë plotësuese u krijon probleme në financimin e aktiviteteve rrjedhëse dhe sidomos kontribuon në grumbullimin e detyrimeve të papaguara të gjykatave në baza të ndryshme;
2. Sipas kësaj, problemi kryesor, me të cilin ballafaqohen gjykatat e anketuara, që mund të supozohet si problem me të cilin ballafaqohet numri më i madh i gjykatave në RM, është mungesa e mjeteve për funksionim papengesa të aktiviteteve rrjedhëse dhe kapitale, si dhe për pagesën e detyrimeve të maturuara në baza të ndryshme. Kjo e krijon dukurinë e grumbullimit të detyrimeve të cilat, në periudhën e analizuar, tek disa gjykata të caktuara shënojnë rritje ndërsa tek gjykata të tjera reduktim, por për asnjë çast të njëjtat nuk duhet të neglizhohen.
3. Mjetet e pamjaftueshme dhe pagesa jo në kohë e obligimeve të maturuara shpeshherë rezultojnë me vendime ekzekutive të cilat ndonjëherë shkaktojnë bllokimin e llogarive të gjykatave. Gjatë prezantimit, përfaqësuesit e gjykatave theksuan se një pjesë e obligimeve janë parashkruar dhe si të tilla shlyhen;
4. Në pjesën më të madhe të gjykatave janë realizuar aktivitete të konsiderueshme investuese me angazhimin e mjeteve nga pjesa e Buxhetit të RM-së i cili i akordohet Ministrisë së Drejtësisë ose me angazhimin e mjeteve nga kredia e Bankës Botërore. Megjithatë, KBGJ dhe gjykatat (e anketuara) e zgjedhura e theksojnë mungesën e mjeteve për aktivitete investuese. Ato, zakonisht financohen me donacione të institucioneve të ndryshme. Në situatat e ofruara për shfrytëzimin e donacioneve disa prej gjykatave ballafaqohen me probleme meqë nuk posedojnë fletë-pronësi si pjesë e dokumentacionit të nevojshëm me të cilin do të aplikonin për fitimin e donacionit.
5. Në nivel të gjyqësorit u miratua Ligji për administrimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata. Ekziston vlerësimi se në bazë të pamjaftueshme janë shfrytëzuar mundësitë dhe nevojat për administrimin me lëndët, që nënkupton planifikim, koordinim, organizim dhe kontroll gjatë përpunimit të lëndëve. Nëse gjykata, përmes vëllimit të lëndëve, nuk mund t'i arsyetoj mjetet e kërkuara, atëherë nuk do të jetë në gjendje të kërkoj shumë përkatëse të mjeteve. Së këtejmi, gjykatat gjithnjë e më shumë vetëdijeshohen për rëndësinë e parashikimit të vëllimit të lëndëve dhe përcaktimin e çmimit të kostos së një lënde, varësisht nga lloji dhe kompleksiteti i lëndëve. Disa gjykata tanimë e kanë caktuar koston e çmimit të lëndëve të caktuara gjyqësore, disa gjykata të tjera janë në fazë intensive të përcaktimit të kostos së çmimit, por tek disa gjykata ka ngecje në këto aktivitete për shkak të vlerësimit të pamundësisë (për shkaqe të ndryshme të cilat janë theksuar në vende tjera të këtij raport) që të përcaktohet çmimi i kostos për një lëndë;

<sup>3</sup> [http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/AFO\\_lzvestaj-za-finansiranje-na-sudovite.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/AFO_lzvestaj-za-finansiranje-na-sudovite.pdf)

6. Raportet e gjykatave nuk janë standarde dhe janë shumë modeste gjatë sqarimit të dukurive, problemeve dhe ngjashëm në punën e tyre. Në raporte nuk mund të vërehet lidhja midis numrit të vendimeve të miratuara në gjykata dhe mjeteve të shfrytëzuara për këtë qëllim. Përfaqësuesit e gjykatave, të cilët ishin të pranishëm në prezantimin e Draft-Raportit, e vunë në dukje nevojën për rritjen e numrit të trajnimeve në lidhje me mënyrën e hartimit të raporteve të gjykatave për institucionet përkatëse, mënyrën e njoftimit të publikut, përpilimit të kërkesës buxhetore dhe ngjashëm, me qëllim të unifikimit të procedurave dhe raporteve të gjykatave;

7. Përveç kësaj, raportet të cilat gjykatat ua dërgojnë KBGJ përbajnë vetëm shifra sipas zërave buxhetorë, ndërkaq mungon analizë komparative gjithëpërfshirëse e shpenzimeve të realizuara me ato të planifikuara, si dhe analizë të shkaqeve për krijimin dhe plan për pagesën e borxheve të papaguara. Një analizë e këtillë nuk bëhet sepse një gjë të këtillë nuk e ka kërkuar askush nga gjykatat, por edhe për shkak të mungesës së personelit;

8. Nga bisedat, të cilat i zhvilloi ekipi me kryetarin e KBGJ, erdhën në konkludim se nga aspekti ekonomik – financiar ekzistimi i 27 gjykatave themelore në Republikën e Maqedonisë është i paarsyeshëm. Kjo e imponon nevojën për rishikimin e nevojës së ekzistimit të mëtutjeshëm të gjykatave në disa vende të caktuara dhe zëvendësimin e tyre me ditë gjykimi ose me seksione gjyqësore;

9. Analizat e KBGJ tregojnë se numri i gjyqtarëve është i madh. Kjo veçanërisht ka të bëjë me numrin e gjyqtarëve në disa gjykata në brendinë e vendit ku është evidentuar numër jo proporcional i lëndëve me numrin e gjyqtarëve. Gjendja e këtillë krijon presion të madh mbi mjetet buxhetore (për paga dhe kontribute nga pagat, mesatarisht shpenzohen rreth 85% deri 90% nga mjetet e përgjithshme të akorduara buxhetore), dhe për këtë shkak gjykatave iu mbeten shuma relativisht të vogla të mjeteve për financimin e aktiviteteve të tyre rrjedhëse dhe investuese. Nga ana tjetër, gjykatat e theksojnë mungesën e personelit administrativ dhe veçanërisht të bashkëpunëtorëve profesionistë, daktilografëve dhe nëpunësve udhëheqës e që u krijon pengesa serioze (ngecje ose zvarritje) gjatë realizimit të lëndëve gjyqësore;

10. Analizat e bilanceve të gjykatave, përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve të parashtruara në pyetësorët dhe intervistat që u zhvilluan me përfaqësuesit e Këshillit Buxhetor Gjyqësor, e konfirmojnë vlerësimin e përgjithshëm se për financimin e aktiviteteve të gjyqësorit në RM, në nivel vjetor duhet të akordohen më së paku 0,5% nga Buxheti i RM-së. Megjithatë, analiza konfirmoi se buxheti vjetor të cilin e ka në dispozicion gjyqësori në RM (Buxheti gjyqësor) lëvizë në nivelin prej 0,3988% (në vitin 2010) deri në 0,2891% të BPV) në vitin 2017) nga Buxheti i RM-së. Sipas kësaj, rezultoi konstatimi se mosrespektimi i obligimit ligjor për akordimin e 0,8% nga Buxheti i RM-së është shkaku kryesor për shfaqjen e problemeve financiare gjatë punës së gjykatave dhe veçanërisht për pagesën jo në kohë të detyrimeve të maturuara të gjykatave;


11. Nuk ekziston harmonizim të kërkesave buxhetore të gjykatave – njësi buxhetore në nivel të juridiksionit të apelit. Sipas ekipit hulumtues, ky fakt vë në dukje mosharmonizime të mundshme në shpërndarjen e mjeteve buxhetore, e që nga ana tjetër shkakton mos-akordim të mjeteve të kërkuara të gjykatave të caktuara ose rishpërndarje të mjeteve nga njëra gjykatë tek tjetra, së këtejmi pa e marrë parasysh (pa) arsyeshmërinë e (mos) realizimit të mjeteve fillimisht të akorduara dhe nevojat për realizimin e detyrimeve të grumbulluara të gjykatave të caktuara. Në të vërtetë, disa gjykata ankohen se gjatë rishpërndarjes së mjeteve në nivel të juridiksionit të apelit, ato nuk janë konsultuar fare për nevojat edhe problemet e tyre për zgjidhjen e të cilave nevojiten mjete financiare, ndërsa në disa raste imponohet nevoja edhe për rritjen e tyre në raport me shumën e përcaktuar fillestare. Megjithatë, disa gjykata konsiderojnë se harmonizimi i këtillë i kërkesave buxhetore, në nivel të juridiksionit të apelit, madje nuk është i nevojshëm. Përfundimisht, nga përfaqësuesit e gjykatave u theksua se për një harmonizim të këtillë nevojitet që ata të kenë kuadro përkatëse profesionale, para së gjithash profesionistë nga fusha e ekonomisë, të cilët janë në numër të vogël, ndërsa në disa gjykata, madje nuk ka asnjë ekonomist të punësuar;

12. Në mënyrë të drejtpërdrejt me problemin paraprakisht të përshkruar ndërlihet edhe problemi të cilin e theksojnë disa gjykata në kuptimin se me cirkularin buxhetor, KBGJ u akordon vetëm 50% nga mjetet e kërkuara, pa u bërë një analizë reale e mjeteve të kërkuara, madje edhe pa konsultime me gjykatat konkrete. Aq më shumë, këto gjykata nuk janë njoftuar për ndryshimet e këtylla, kështu që nuk kanë pasur informacione për shkaqet e shkurtimit të këtylla të mjeteve, dhe as ndonjë udhëzim për planifikimin e ardhshëm të mjeteve të nevojshme. Në situata të këtylla, shpërndarja e mjeteve të buxhetit gjyqësor bëhet në bazë të kërkesave buxhetore të njëjësive – shfrytëzues të përgatitur në bazë të buxhetit të vitit paraprak, të harmonizuara me tavanin e mjeteve të akorduara nga KBGJ, përkatësisht nga Ministria e Financave. Mënyra e këtillë e përlogaritjes së buxhetit nuk siguron punë efikase në bazë të planifikimit të nevojave, dhe as shpërndarje të drejtë të mjeteve, përkatësisht disa gjykata pranojnë më pak mjete nga të nevojshmet (për shkak të vëllimit të rritur të punës), ndërsa gjykata të tjera pranojnë më shumë mjete nga të nevojshmet;

13. Sistemi i deritanishëm i buxhetimit, për shkak të mos-përcaktimit të prioriteteve të financimit, si dhe për shkak të mungesës së analizës së detajuar të shkaqeve për realizimin jopërkates të buxhetit, nuk siguron administrim të mirë me mjetet buxhetore. Ky sistem i buxhetimit sipas zërave nuk ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të nevojave dhe as që mundëson planifikim të mjeteve për një periudhë trevjeçare (në përputhje me ligjin);

14. Shpenzimet gjyqësore, që paraqiten në procedura ku si palë paraqiten organe të tjera, i paguajnë gjykatat. Megjithatë, pas përfundimit të procedurave, refundimi i mjeteve bëhet në buxhetin shtetëror dhe jo në buxhetin gjyqësor, e që shpie në rritjen e shpenzimeve të gjykatave.

15. Gjykatat dhe KBGJ nuk janë ekipuar dhe nuk janë trajnuar sa duhet për kryerjen e menaxhmentit financiar. Sistematizimet e tyre parashikojnë seksion për punë financiare dhe materiale i cili, sipas përshkrimit të detyrave të punës, e përfshinë vetëm përgatitjen e buxhetit dhe kontabilitetin, por nuk e përfshinë administrimin financiar dhe kontrollin. Për administrimin financiar dhe kontrollin nevojitet të inkorporohet planifikim i detajuar dhe analizë e punës dhe shfrytëzimit të resurseve nëpër gjykata ndërkaq, nga ana tjetër, edhe sigurimin e burimeve të sigurta dhe të qëndrueshme të financimit të pushtetit gjyqësor. Megjithatë, siç theksuam më lartë, për planifikim cilësor dhe analizë nevojitet edhe personel i mjaftueshëm dhe adekuat profesional i cili është përfaqësuar në numër të vogël në gjykata.



## Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim | A do të ketë “bilbilfryrës” në universitete? Mundësitë e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe parandalimin e korrupsionit në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë<sup>4</sup>

### Konstatime kryesore

Në bazë të hulumtimit të zbatuar, në lidhje me mundësitë për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve në parandalimin e korrupsionit në arsimin e lartë në RM, arritëm në disa konkluzione:

>>> Anketa me studentët tregoi se korrupsioni në arsimin e lartë akoma është i pranishëm. Tendencat, sa i përket korrupsionit në arsimin e lartë nuk shënojnë ndryshim më të konsiderueshëm, krahasuar me hulumtimin e zbatuar në vitin 2012.

>>> Në pjesën e pyetjeve për përcaktimin e gjendjeve me korrupsionin në arsimin e lartë, u konstatua se ekziston dallim sa u përket pyetjeve të pranuar të cilat i matin përvojat kundrejt perceptimeve të **studentëve**. Me fjalë të tjera, një numër i vogël i studentëve janë përgjigjur se në të kaluarën kanë qenë viktimë të korrupsionit gjatë studimeve të tyre edhe atë gjithsej 36, përkatësisht 7% nga të anketuarit, ndërsa vetëm 12 deklaruan se në të kaluarën kanë qenë viktimë të korrupsionit. Nga ana tjetër, numri i studentëve të cilët kanë deklaruar se kanë qenë dëshmitarë okularë, përkatësisht në të kaluarën kanë dëgjuar diçka për ndonjë tentativë për korrupsion, në masë të konsiderueshme është më i lartë edhe atë 12%, përkatësisht 47%, respektiv.

>>> Edhe pse më shumë se gjysma e studentëve të anketuar konsiderojnë se në universitetet ekziston korrupsioni, ndërsa 7% e të anketuarve janë deklaruar se kanë qenë viktimë e korrupsionit, në universitete nuk janë regjistruar raste të denoncuar për korrupsion. Kjo tregon se mekanizmat ekzistues për parandalimin e korrupsionit në arsimin e lartë janë jofunksional.

>>> Praktikë më e shpeshtë, kundër të cilës reagojnë studentët, është detyrimi që të blejnë tekst shkollor që ta japin provimin e lëndës ose që të fitohet notë më e lartë.

>>> Gjithsej 78% e studentëve të anketuar kanë deklaruar se nuk do të denonconin vepra korruptive meqë kanë frikë, ose kanë vlerësuar se denoncimi i tyre nuk do të ndryshoj asgjë, përkatësisht se nuk do të ndërmerren masa për të njëjtin. Kjo na shpie në konkluzionin se nuk ekziston ambient besimi ndaj institucioneve kompetente për parandalimin ose denoncimin e korrupsionit.

>>> Një numër relativisht i ulët nga juristët e ardhshëm në vend (rreth 10%) janë në dijeni se ekziston Ligji për mbrojtjen e denoncuesve.

>>> Përveç informacioneve të pamjaftueshme për ekzistimin e ligjit dhe për materien që e rregullon, studentët e fakulteteve juridikë, në masë të madhe, nuk janë të njoftuar se institucioni në të cilin studiojnë a ka caktuar person përgjegjës për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit dhe kush është emri i atij personi. Sondazhi tregoi se studentët kanë besim më të madh tek dekanët, tek avokatët e studentëve, mediat dhe rektorët, sipas kësaj radhitje, si instanca në të cilat ku do t'i denonconin dyshimet ose informatat e tyre për vepër të kryer korruptive.

>>> Vendi më adekuat në të cilin mund të prezantohet përmbajtja dhe të diskutohen mundësitë që i ofron Ligji për mbrojtjen e denoncuesve janë ligjëratat e rregullta në fakultete, edhe pse ekziston mundësi për informim plotësues në ueb-faqen, përkatësisht në profilet e rrjeteve sociale të fakulteteve, si dhe përmes organizimit të tribunave dhe debateve publike të ndryshme.

>>> Ngjashëm si studentët edhe **personat e punësuar** në universitete nuk janë të njoftuar me ekzistimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, si dhe mundësitë që i ofron Ligji në aspekt të parandalimit të korrupsionit në arsimin e lartë.

<sup>4</sup> <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/2017-ISIE-Policy-Study-Will-there-be-%E2%80%98Whistleblowers%E2%80%99-at-the-Universities.pdf>

>>>Midis personave të cilët punojnë në fakultetet/universitetet e vendit ka një pajtueshmëri të përgjithshme se do të denoncin dyshim të arsyeshëm ose informacion për vepër të kryer penale përmes shfrytëzimit të mekanizmave për denoncim të parashikuar në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve. Së këtejmi, shumica e këtyre personave parapëlqejnë të denoncojnë në formë të shkruar, sesa në formë verbale në procesverbal.

>>>U vërejt se dekanët, si persona udhëheqës të fakulteteve, gëzojnë besim të konsiderueshëm si instancë për paraqitjen e denoncimeve nga denoncuesit (87% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë besim).

>>>Konkluzion i përgjithshëm korrespondon me atë se të punësuarit në fakultetet juridike kanë nivel mesatar të besimit ndaj të gjitha kategorive të theksuara të personave udhëheqës (rektor, prorektor, dekan, prodekan, udhëheqës i institutit, udhëheqës i katedrës, sekretar i fakultetit) si persona përgjegjës për pranimin e denoncimeve nga ana e denoncuesve.

>>>Të punësuarit në fakultetet juridike kanë besim të ulët tek institucionet e parashikuara me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve gjatë denoncimit të mbrojtur të jashtëm (Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Themelore Publike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit), me përjashtim të Avokatit të Popullit të RM.

>>>Mbizotëron qëndrimi se Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, i cili e garanton mbrojtjen e personave të cilët denoncojnë (denoncuesit) do t'i inkurajoj studentët më shpesh të denoncojnë vepra të korrupsionit, por nga ana tjetër i njëjti nuk ofron mbrojtje të sigurt dhe efikase të zbulimit të identitetit të personit i cili do të denoncoj një vepër të korrupsionit në arsimin e lartë.

## Rekomandime

Duke e pasur parasysh këtë që e thamë më lartë, i përcaktuam **rekomandimet** dhe i adresuam deri tek bartësit kryesorë të interesave, si vijon:

### Deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë:

1. Të riformulohet neni 2 paragrafi 3 alineja 6 e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Personat që mund të jenë në cilësinë e denoncuesve, të theksuar në këtë aline, duhet të përcaktohen në mënyrë më precize dhe më të qartë;
2. Të ndryshohet Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias, në pjesën e mekanizmave për avancimin e implementimit të ligjit;
3. Të bëhet vlerësim më adekuat për nevojën e miratimit të ligjeve, sidomos në rastet kur institutet dhe zgjidhjet ligjore, karakteristike për sistemin juridik anglosakson, inkorporohen në legjislacionin maqedonas.
4. Të përmirësohet ambienti i përgjithshëm për respektimin dhe zbatimin e ligjeve në vend.


### Deri te universitetet:

1. Në përputhje me Ligjin, Universitetet duhet të emërojnë persona të autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit, ndërsa të njëjtat duhet të jenë të aksesshme dhe të publikohen;
2. Të përgatisin një material të shkurtër informativ në lidhje me atë se çka është korrupsioni dhe si mund të denoncohet dhe të njëjtin t'ua shpërndajnë studentëve në fillim të vitit shkollor dhe ta publikojnë në ueb-faqen e universitetit dhe fakulteteve;
3. Në kuadër të trajnimeve për të punësuarit të përfshihen përmbajtje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e denoncuesve dhe me denoncimin e mbrojtur të brendshëm;
4. Të shqyrtohet mundësia e miratimit të aktit për politikën e mbrojtjes së denoncuesve në nivel të universitetit;
5. Duke e pasur parasysh se anketa tregoi se obligimi për blerjen e teksteve shkollore, si kusht për t'iu nënshtruar provimit, për studentët është një lloj dominant i korrupsionit, ndërsa universitetet duhet të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme dhe të pranueshme për këtë çështje;
6. Të publikojnë raporte vjetore për rastet e denoncuara të korrupsionit, si dhe mënyrat se si është vepruar. Në këtë mënyrë do të rritet besimi dhe do të inkurajohen studentët të denoncojnë keqpërdorime;
7. Të inkurajohet stafi mësimor që në përmbajtjet e programeve mësimore të përfshijnë përmbajtje në lidhje me korrupsionin, veçanërisht në pjesën e kornizës juridike dhe modeleve alternative për mbrojtjen e denoncuesve;

8. Të organizohen tribuna, tryeza të rrumbullakëta ose debate publike të tipit të hapur, në të cilat do të mund të marrin pjesë edhe studentët e fakulteteve juridikë, ku do të mund të edukohen për zgjidhjet rrjedhëse ligjore dhe për implikimet nga zbatimi i tyre. Kështu që, në mënyrë plotësuese do të përforcohet besimi ndaj institucionit.

#### Deri te organizatat studentore/avokati i studentëve:

1. Duhet të kenë rol proaktiv në mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe të iniciojnë dialog midis studentëve dhe fakulteteve për çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin.
2. Duhet të vendosin mekanizëm për informimin e studentëve dhe ofrimin e ndihmës në rastet e keqpërdorimit.
3. Përmes hapjes së kësaj teme në publik, të stimulohet ndërtimi i besimit të studentëve ndaj institucioneve të cilat i kanë në dispozicion.





## Koalicioni të gjithë për gjykim të drejtë | Monitorimi i implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në Gjykatën Themelore Shkup I dhe Shkup II<sup>5</sup>

### Qëllimi dhe përfshirja e hulumtimit

Me qëllim që të rritet besimi i publikut ndaj sistemit juridik, si dhe të identifkohen problemet gjatë funksionimit të sistemit gjyqësor, u imponua nevoja për zbatimin e vazhdueshëm të hulumtimit në lidhje me implementimin e standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në kuadër të punës së Gjykatës Themelore Shkup I dhe Shkup II.

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e besimit të publikut ndaj sistemit juridik dhe gjyqësorit, përmes identifikimit të problemeve në sistemin gjyqësor, ndërsa njëkohësisht edhe përmes potencimit të nevojës për reforma juridike dhe institucionale përmes të cilave do të sigurohet respektim më i madh i standardeve për gjykim të drejtë para gjykatave vendase, si dhe njoftimi i publikut me standardet për gjykim të drejtë.

Projekti u zbatua në nivel lokal, përmes monitorimit të implementimit të standardeve për gjykim të drejtë në kuadër të punës së Gjykatës Themelore Shkup I dhe Shkup II në Shkup. Objekt i analizës ishte puna e Gjykatës Themelore Shkup I dhe Shkup II, veçanërisht në pjesën e implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë, përmes zbatimit të monitorimit mbi modelin e zgjedhur nga 80 lëndë gjyqësore (60 lëndë penale dhe 20 civile), me qëllim që të shqyrtohet zbatimi i standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë gjatë procedurës gjyqësore.

Metodologjia e cila u shfrytëzua nga Koalicioni për grumbullimin e të dhënave nga këto gjykime, për nevojat e kësaj analize përbëhej nga shfrytëzimi i dy metodave: 1) monitorimi i procedurave gjyqësore gjatë kohës së mbajtjes së tyre, 2) pyetësor i sistematizuar në të cilin pas monitorimit të kryer futen të dhënat e shënuara.

---

Në kuadër të monitorimit të zbatuar ndaj procedurave gjyqësore, në juridiksionin e Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe Gjykatës Themelore Shkup 2, u monitoruan gjithsej 97 procedura gjyqësore, prej të cilave – 74 lëndë penale dhe 23 civile, përkatësisht 120 seanca gjyqësore në Gjykatën Penale dhe 35 në atë Civile. Kjo shifër e lëndëve e tejkaloi shifrën fillimisht të parashikuar, me qëllim që të fitohet përfshirje më e madhe e të dhënave objekt i përpunimit. Intenca ishte të përcaktohet shkalla e implementimit të standardeve për gjykim të ndershëm dhe të drejtë në dy gjykatat më të mëdha të shtetit.

---

### Procedura penale

Gjatë monitorimit të zbatuar mbi procedurat penale, monitoruesit kishin mundësi të monitorojnë lëndë nga fusha të ndryshme, kështu që veprat penale më të përfaqësuara gjatë monitorimit ishin: “Vjedhje e rëndë”, “Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve”, “Mashttrim”, “Trafikim me qenie njerëzore”.

### Procedura civile

Monitorimi i cili u zbatua mbi procedurat civile në Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup, u realizua sipas lëndëve konkrete, paraprkasht të selektuara, në përputhje me bazën e lëndëve. Kështu që, nga procedurat civile, duke e pasur parasysh faktin se e drejta civile është një det i bazave të shumëllojshme, u monitoruan lëndë në këto baza: “pronësia”, “diskriminimi”, “shpifja dhe ofendimi” në të cilat ishim të mendimit se këto standarde, standardet për gjykim të ndershëm dhe të drejtë, do të duhej të praktikohen në masë të madhe, konform specifikës së bazave.

5 [http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Megunarodni-standardi\\_fer-i-pravicno-sudenje.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Megunarodni-standardi_fer-i-pravicno-sudenje.pdf)



Analiza e procedurave gjyqësore u realizua përmes vlerësimit të parametrave të përcaktuara nga KEDNJ dhe nga ana e GJEDNJ, sa i përket sistemit të drejtave përmes të cilave vlerësohet nëse një procedurë penale është e ndershme dhe e drejtë, përkatësisht përmes evaluimit të parimit të procedurës së drejtë. Në këtë drejtim, u analizuan elementet e veçantë të parimit për procedurë të drejtë, sipas kësaj radhitje: pavarësia dhe paanshmëria; gjykimi në kohë – gjykimi në afat të arsyeshëm; transparenca; prezumimi i pafajësisë; barazia e armëve; respektimi i të drejtave minimale të mbrojtjes (njoftimi në afat sa më të shkurtër për natyrën dhe shkaqet e akuzës); kohë e mjaftueshme dhe mundësi për t'u përgatitur mbrojtja; të mbrohet personalisht ose me avokat mbrojtës; ai vet ose me avokat mbrojtës t'u shtroj pyetje dëshmitarëve; ndihmë falas nga përkthyesi) dhe të drejtë ankese.

## Konkluzionet që rezultuan nga projekti i zbatuar

Nga monitorimi i zbatuar dhe nga të dhënat e fituara, mund të konkludojmë se kohëzgjatja e monitorimit të procedurave gjyqësore është tepër e shkurtër që të nxjerrim konkluzione të qarta sa i përket implementimit të përgjithshëm të të gjitha standardeve për gjykim të drejtë.

Është fakt i pakontestueshëm se monitoruesit gjatë monitorimit të zbatuar, procedurat i kanë "hasur" në faza të ndryshme, disa në fillim, disa në fazën e nxjerrjes së provave, ndërsa disa të tjera në fund dhe, së këtejmi mund të themi se nuk ekziston kontinuiteti i nevojshëm që me siguri të konstatohet se në një procedurë gjyqësore, nga fillimi e deri në fund, në mënyrë konsekuente respektohen këto standarde. Megjithatë, nga ana tjetër, në mënyrë të detajuar, varësisht nga ajo se në cilën fazë ka qenë procedura, mund të vlerësojmë nëse ky parim, përkatësisht e drejtë e standardeve, është respektuar.

>>> Në bazë të të dhënave, padysim se mund të nxjerrim konkluzione se në përgjithësi gjykatat funksionin e tyre e kryejnë në mënyrë të paanshme dhe profesionale, duke e pasur parasysh se në lëndët nuk është evidentuar se është kërkuar përjashtim i gjyqtarit, pikërisht në këtë bazë.

>>> Kur bëhet fjalë për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm, në bazë të të dhënave të pranuar, mund të konkludojmë se procesi i monitorimit ishte tepër i shkurtër që të përcaktohet koha e stërzgatur e procedurës, kjo veçanërisht nëse merret parasysh fakti se mesatarisht një procedurë në gjykatën penale zgjat rreth 6 muaj, ndërsa në gjykatën civile 1 vit. Nga ana tjetër, mungojnë të dhëna statistikore në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm të cilat paraqiten në Gjykatën Supreme të RM-së, në mënyrë që prej tyre të nxjerrim konstatime se sa shpesh është cenuar kjo e drejtë, si funksionon ky mekanizëm në lidhje me përcaktimin e kompensimit të dëmit material për cenimin e kësaj të drejte dhe ngjashëm.

>>> Në pjesën e standardeve që kanë të bëjnë me parimin "barazia e armëve", monitoruesit nuk kanë hasur në rrethana të cilat do të aludonin në moszbatimin e këtij parimi, përkundrazi në pjesën e procedurave penale, në masë të madhe, është konstatuar respektimi i këtij parimi, veçanërisht në pjesën e mundësive të barabarta për propozimin e provave të të dyja palëve në procedurë. E vetmja që do të mund të detektohet si specifike konsiston me atë që është problematike gjetja dhe sigurimi i provave në fazën e hershme të procedurës penale, përkatësisht në fazën e hetimit, kështu që në këtë drejtim edhe më tutje gjatë seancës kryesore paraqitet efekti kur disa prova të caktuara të propozuara nuk mund të gjenden fare ose të nxirren para gjykatës.


>>> Transparenca e gjykimit është njëra nga garancitë më të rëndësishme për veprimin e ndershëm të gjykatës. Përmes transparencës së procedurave gjyqësore gjenerohet konkluzioni për efikasitetin gjyqësor dhe për perceptimin e tij si mbrojtës i barabartë i të drejtave të subjekteve të procedurave penale që zhvillohen para gjykatës përkatëse. Varësisht nga ajo se si do të shqyrtohet si parim, do të kishim qëndrime dhe kundërshtime të dyanshme. Me fjalë të tjera, nëse me transparencë nënkuptojmë mbyllje të gjykimit nga aspekti i restriksionit fizik të personave, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk janë të prekur nga procedurat, përveç të gjykimeve në të cilat për shkaqe ligjore është përcaktuar se përjashtohet publiku, mund të konkludojmë se publikut, në masë të konsiderueshme të lartë, i mundësohet pjesëmarrja në seancat gjyqësore. Megjithatë, nëse publikun e identifikojmë përmes parametrave të transparencës së të dhënave, prej të cilave publiku i merr informacionet për procedura të caktuara gjyqësore, atëherë mund të detektojmë jokonsekuenca. Kjo, veçanërisht nga aspekti i mos-korrespondimit të të dhënave të publikuara në ueb-faqen e gjykatës ose të atyre të cilat i kemi pranuar zyrtarisht, me situatën ad-hok, por edhe nga aspekti i jo-transparencës absolute të të dhënave për kohën dhe vendin e mbajtjes së gjykimit, e që në mënyrë transparente duhet të publikohen pranë sallave të gjykimit.

>>> Kur bëhet fjalë për të drejtat e të akuzuarve, nga të dhënat e pranuar mund të konstatohet se gjykata, shumë shpesh, vetëm i numëron të drejtat e personit të akuzuar, pa u siguruar nëse ky person i kupton me të vërtetë dhe është i aftë që t'i gëzojë të njëjtat gjatë procedurës penale. Në përputhje me këtë konstatim jemi të mendimit se është e domosdoshme të çrënjaset kjo praktikë e keqe e gjykatës, me ç'rast do të inkorporohet praktika e sqarimit të plotë, gjithëpërfshirës dhe të kuptueshëm të gjykatës për personin e akuzuar. Sa i përket prezencës së avokatëve mbrojtës



me procedurat penale, të dhënat sugjerojnë se një përqindje e caktuar e të akuzuarve nuk kanë avokat mbrojtës, përkatësisht 32 persona të akuzuar, që e vë në pikëpyetje mundësinë që këta persona në mënyrë të pavarur të vijnë deri te konstatimi i të vërtetës, përkatësisht të vijnë deri te drejtësia. Sa i përket të drejtës për ndihmë juridike falas, përsëri janë aktuale vërejtjet, nga raporti i vitit të kaluar, sipas të cilave i imponohet obligimi gjykatës të jetë më e kujdesshme gjatë shqyrtimit të mundësive për zbatimin e të drejtës së ndihmës juridike falas. Edhe një segment tjetër, i përfshirë në pjesën e të drejtave të prokurorëve, e parashikon të drejtën e përkthyesit gjatë procedurave. Për këtë çështje janë parashikuar zgjidhje ligjore, si në LPP (për të akuzuarit dhe palët në procedurë), ashtu edhe në LPK (për palët në procedurë), megjithatë, krahas dispozitave të përcaktuara ligjore, të dhënat e përpunuara e vënë në dukje zbatimin absolut të kësaj të drejte në procedurat penale, por jo edhe në ato civile.

>>>E drejta e ankesës, përkatësisht e publikimit të aktgjyimit dhe shfrytëzimit të së drejtës së ankesës, mund të konstatojmë se e njëjta nuk zbatohet plotësisht në asnjërën nga dy gjykatat (gjykatën penale dhe civile). Në gjykatën penale kemi përqindje të lartë prej 20% të lëndëve të monitoruara, në të cilat aktgjykimi nuk është bërë publik, ndërsa në procedurat civile, duke e pasur parasysh se edhe vet proceset gjyqësore zgjasin një kohë më të gjatë, kështu që monitoruesit nuk kanë mundësi t'i monitorojnë prej fillimi e deri në fund të gjyimit, kemi një përqindje të ulët të lëndëve të evidentuara dhe të përfunduara, në mënyrë që të nxjerrim të dhëna relevante për përqindjen e aktgjyimeve të publikuara. Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për respektimin e të drejtës së ankesës, përsëri ky konstatim dhe konkluzion ka të bëjë me veprat penale, kështu që ballafaqohemi me përqindje të lartë prej 34% në dëm të të akuzuarve gjatë procedurave. Së këtejmi, këto të dhëna, nënkuptohet se janë pranuar vetëm nga seancat gjyqësore të monitoruara, atëherë kur gjykata në mënyrë publike e ka miratuar dhe publikuar aktgjykimin pas përfundimit të seancës kryesore.





## Multikultura | Ndhimja juridike falas – sfidat dhe zgjidhjet<sup>6</sup>

### Qëllimi dhe përfshirja e hulumtimit

Në kuadër të projektit “Ndhimë juridike falas”, Shoqata Multikultura e përpiloi këtë analizë, me qëllim që të identifikohen sfidat gjatë dhënies së ndihmës juridike falas, kurse nga ana tjetër që të jepen rekomandime për përmirësimin e të njëjtës.

Analiza e NJF u fokusua mbi zbatimin e Ligjit për ndihmë juridike falas, nga miratimi i të njëjtit në vitin 2006, duke i krahasuar të dhënat e raporteve të MD dhe të organizatave të tjera të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas.

Përfshirja kohore e kësaj analize është nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2016

Deri te analiza e detajuar, për zbatimin e Ligjit për Ndhimë juridike falas dhe të dhënave statistikore, u përpoqëm të arrijmë përmes anketave të qytetarëve dhe intervistave të realizuara me ekspertë nga fusha e Ndhimës juridike. Numri i anketave të realizuara kap një shifër prej 500 pjesëmarrësish, me vendbanim në Tetovë, prej të cilëve 51% janë të gjinisë femërore, ndërsa 49% të gjinisë mashkullore. Pjesëmarrësit u përkisnin tri grupmoshave, edhe atë: grupmosha nga 16-25 u prezantua me 31%, grupmosha 26-35 u prezantua me 46% dhe grupmosha mbi 36 vjet u prezantua me 23%.

Nga ana tjetër, u intervistuan edhe katër shoqata të regjistruara në Republikën e Maqedonisë, të cilat janë të autorizuar për dhënien e NJF: CRJUZ, ROMA SOS, QNR Kumanovë dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj.

Përveç këtyre intervistave, Shoqata Multikultura i intervistoi edhe përfaqësuesit e MD - Njësia rajonale Tetovë. Qëllimi i kësaj interviste ishte që të fitohet pasqyrë reale për numrin e kërkesave të paraqitura për NJF, në lidhje me atë sa prej tyre u miratuan dhe sa u refuzuan.

Kjo analizë ofron të dhëna të detajuara për disa fusha, siç janë: numri i kërkesave të paraqitura, sa kërkesa janë paraqitur në fusha të caktuara, a ka dallime midis qyteteve në lidhje me kërkesat e paraqitura, numri i kërkesave të miratuara kundrejt kërkesave të refuzuara, për cilat çështje juridike janë paraqitur më shumë kërkesa për NJF, kushtet për fitimin e të njëjtës, a janë plotësuar lehtësisht, personat të cilëve u është refuzuar kërkesa, a kanë mundësi të paraqesin instrument juridik, financimi i NJF dhe fusha të ngjashme.

### Konkluzione

Edhe pas 8 viteve, nga miratimi i Ligjit për ndihmë juridike falas, dhe 7 vjet e gjysmë nga zbatimi i të njëjtit, akoma ballafaqohemi me problemet e njëjta themelore, me të cilat ballafaqoheshim qysh në fillim të zbatimit të Ligjit. Implementimi akoma nuk është në nivelin e duhur që të themi se Ligji është tërësisht funksional.

Konkluzionet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për ndihmë juridike falas:

>>>Edhe pas 8 vjetëve nga miratimi i Ligjit numri i kërkesave gjatë kësaj periudhe kohore akoma nuk e ka arritur numrin 1 000, në një shoqëri në të cilën 25% e popullatës nuk është e punësuar dhe janë raste sociale.

>>>Ballafaqohemi me konfuzion në lidhje me normat e Ligjit, në të cilat në disa aspekte janë shumë të paqarta dhe nuk ka sqarime plotësuese për të njëjtat.

>>>Kërkesat, të cilat edhe ashtu janë në numër të vogël, shumica e tyre refuzohen për shkaqe të ndryshme por, ndonjëherë edhe për shkaqe të pabazuara.

>>>Shoqatat, të cilat aktualisht janë në një numër pak më të madh në krahasim me periudhën e fillimit të zbatimit të Ligjit (në regjistër ka rreth 10 në gjithë territorin e RM-së), nuk pranojnë kurrfarë ndihme nga shteti për shpenzimet të cilat krijohen gjatë dhënies së ndihmës juridike paraprake, madje ky është njëri nga shkaqet pse shumica e shoqatave nuk janë regjistruar si ofrues të Ndhimës juridike falas.

<sup>6</sup> <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Ndhimja-juridike-pa-pages%C3%AB-sfidat-dhe-zgjidhjet.pdf>

>>>Siç theksuam më lartë, buxheti i mjeteve në vend që të reduktohet, nga viti në vit, duhet të shfrytëzohet për dedikime tjera pa dal nga fusha e Ndhmës juridike falas.

>>>Shtatë vjet pas implementimit të Ligjit, mos-informimi i qytetarëve është akoma në nivel të lartë, duke e pasur parasysh se Ministria, promovimin e tij nuk e bën në nivelin e nevojshëm, edhe pse në Ligj është përcaktuar se Ministria, në çdo 6 muaj, duhet ta azhurnoj ueb-faqen, ndërsa informacionet e fundit në Regjistrin e avokatëve, si ofertues të Ndhmës juridike falas janë nga viti 2012, ndërkaq numri i avokatëve është 214.

## Rekomandime

1. Përfshirja më e madhe e çështjeve juridike, për të cilat mund të miratohet ndihma juridike, si dhe lehtësimi i kushteve të cilat duhet t'i plotësojnë kërkuesit e ndihmës juridike falas.
2. Nevojat juridike të qytetarëve duhet të pasqyrohen plotësisht në kuadër të Ligjit të ri për Ndhmë juridike falas, me qëllim të sigurimit të qasjes së barabartë deri te drejtësia. Së këtejmi, fushat juridike, në vend që të numërohen taksativisht dhe të jenë përjashtuese duhet t'i përfshijnë të gjitha çështjet dhe problemet juridike me të cilat ballafaqohen qytetarët. Pastaj, që të përfshihen të gjithë qytetarët të cilëve u nevojitet ndihma juridike, duhet t'u lehtësohen kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë qytetarët që t'ju mundësohet ndihma juridike falas.
3. Shpenzimet që duhet të përfshihen me të drejtën e ndihmës juridike falas.
4. Sa u përket shpenzimeve, nga praktika e deritanishme, paraqitet nevoja që e drejta për ndihmë juridike falas t'i përfshijë të gjitha shpenzimet të cilat burojnë nga një kontest i caktuar juridik, për të cilin është miratuar ndihma juridike falas.
5. Zgjerimi i përfshirjes së ndihmës paraprake juridike falas dhe financimi i punës së shoqatave. Ndhma paraprake juridike falas, të cilën shoqatat e autorizuara dhe njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë ua ofrojnë qytetarëve, sipas modelit të sistemeve juridike të cilët janë objekt të analizës komparative, krahas këshillave juridike dhe plotësimit të kërkesës për ndihmë juridike falas duhet të përfshijë edhe përpilimin e shkresave/dokumenteve të thjeshta për procedurën administrative. Financimi paraprak, përkatësisht garancia për shoqatat është mekanizmi më i mirë që shoqatave t'u sigurohet qëndrueshmëri dhe punë efikase.
6. Decentralizimi i miratimit të vendimeve sipas kërkesave për ndihmë juridike falas.
7. Decentralizimi është kyç kur bëhet fjalë për afate të shkurtra të cilat duhet të respektohen, ndërsa njëkohësisht përmes procedurave në disa shkallë, do të sigurohet edhe siguri më e madhe juridike për qytetarët.
8. Ligji për ndihmë juridike falas duhet të harmonizohet me ligjet e tjerë me të cilët është i ndërlidhur. Ligji për ndihmë juridike falas është pjesë e sistemit juridik të Republikës së Maqedonisë dhe mund të implementohet plotësisht vetëm nëse është në përputhje me të gjitha ligjet materiale dhe procesuale, së këtejmi, në mesin e atyre ligjeve me të cilët ka një ndërlidhje të ngushtë janë: Ligji për procedurë kontestimore, Ligji për procedurë penale, si dhe Ligji për noterin.
9. Formimi i trupit të pavarur për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të Ligjit për ndihmë juridike falas.
10. Elementi kryesor, i cili duhet të përfshihet me Ligjin e ri për ndihmë juridike falas, është formimi i trupit të pavarur i cili do ta garantoj qasjen e barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, do të vendos në shkallë të dytë sipas ankesës për aktvendimin e miratuar, si dhe do të ketë kompetenca të tjera të specifikuara me ligj, të cilat janë përfshirë në vazhdim të këtij dokumenti.

## Hapni dritaret | Aksesi dhe inkluziviteti i gjykatave në Maqedoni<sup>7</sup>

### Qëllimi dhe përfshirja e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është të ofroj pasqyrë për gjendjen aktuale sa i përket aksesit dhe inkluzivitetit të gjykatave në Maqedoni, si dhe shërbimeve të tyre për personat me aftësi të kufizuara, përmes:

- >>> të dhënave për hyrje-dalje fizike në objektet e gjykatave;
- >>> të dhëna për aksesin e shërbimeve të gjykatave dhe informacioneve të cilat i prodhojnë gjykatat në kuadër të punës së tyre, dhe
- >>> informata për përgatitjen e kuadrit gjyqësor të punoj dhe të ofroj shërbime për persona me aftësi të kufizuara të ndryshme.

Sipas karakterit të tij hulumtimi ishte i kombinuar, meqë për sigurimin e të dhënave u shfrytëzua qasja kuantitative - kualitative:

Për sigurimin e të dhënave kuantitative u shfrytëzua metoda e anketës, me ç'rast u shfrytëzua instrumenti Pyetësor anketues për hulumtimin e aksesit dhe inkluzivitetit të gjykatave në Maqedoni. Nëse gjykata e kishte caktuar personin përgjegjës për personat me aftësi të kufizuara, atëherë pyetësi anketues i dërgohej atij personi; nëse gjykata nuk e kishte caktuar personin përgjegjës, atëherë sipas rekomandimit të gjykatës pyetësi i dërgohej personit përkatës për kontakt.

Një pjesë e të dhënave u siguruan edhe përmes hulumtimit në terren që mbështetej në aplikimin e dy metodave: intervistë gjysmë e strukturuar dhe observimi. Nga njëra anë, hulumtimi në terren siguroi njohuri më të thella dhe të detajuara për aksesin e gjykatave por, nga ana tjetër, ishte mundësi për kontrollin e të dhënave të siguruara përmes hulumtimit anketues. Kjo, veçanërisht ka të bëjë me vetëvlerësimin e gjykatave në lidhje me aksesin e shërbimeve. Sa u përket vizitave në terren u shfrytëzua instrumenti Udhëzues për intervistë dhe observim gjatë vizitave të gjykatave.

Për nevojat e hulumtimit në terren u angazhuan tre bashkëpunëtorë të jashtëm me aftësi të kufizuara të ndryshme, përfshirë këtu edhe dëmtimin e dëgjimit dhe dëmtimin e shikimit.

Gjatë hulumtimit u shfrytëzua edhe metoda, Studimi i rastit.

### Konkluzione

Në këtë pjesë të raportit janë prezantuar konkluzionet të cilat mbështeten mbi konstatimet e fituara nga hulumtimi anketues dhe vizitat në terren të gjykatave në Maqedoni.

- >>> Përvojat e deritanishme të gjykatave në Maqedoni konfirmojnë se ekziston mungesë e informacioneve dhe njohurive për konceptin e aftësisë së kufizuara dhe aksesit. Kushtet fizike në të cilat sigurohen shërbimet për personat me aftësi të kufizuara nuk janë në nivelin adekuat që t'u përgjigjen kërkesave të tyre. Së këtëjmi, një pjesë e shërbimeve që i ofrojnë gjykatat janë të pa-akseshme për personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht shërbimet ekzistuese nuk janë të mjaftueshme.
- >>> Standardet për hyrje-dalje të brendshme në objektet nuk janë zbatuar nëpër gjykata, ndërsa mundësitë për hyrje-dalje dhe lëvizje të pavarur nëpër hapësirat e gjykatave janë të kufizuara për personat me aftësi të kufizuara.

<sup>7</sup> Raporti është i aksesshëm në: <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Pristapnost-i-inkluzivnost-na-sudovite-vo-Makedonija.pdf>

>>> Sipas të dhënave të siguruara dhe konform Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili në nenin 8, pikën 2 thotë: **“Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara mendore ose trupore ekziston edhe atëherë kur nuk do të ndërmerren masa për eliminim e kufizimeve, përkatësisht përshtatjen e infrastrukturës dhe hapësirës, shfrytëzim të resurseve publikisht të aksesshme, ose pjesëmarrje në jetën publike dhe shoqërore”** vijmë në konkluzion se personat me aftësi të kufizuara ballafaqohen me diskriminim, për shkak të kushteve të pasiguruara adekuate dhe aksesit, në rrugën për realizimin e aksesit deri te drejtësia.

>>> Kuadri gjyqësor përpiket dhe u ofron ndihmë personave me aftësi të kufizuara, edhe pse akoma nuk është edukuar dhe trajnuar t'i identifikoj dhe të sillt në mënyrë përkatëse me personat me aftësi të kufizuara.

>>> Në gjykata mungojnë të dhëna statistikore për numrin e personave me aftësi të kufizuara, të cilët kanë realizuar shërbime ose kanë qenë të përfshirë në ndonjë proces gjyqësor. Gjatë hulumtimit është konstatuar se nuk ka një qasje të unifikuar dhe sistematike në këtë çështje, përkatësisht e njëjta, deri më tani, nuk është evidentuar dhe nuk është ngritur në nivel të detyrueshëm për çdo gjykatë.


>>> Gjykatat përpiqen të sigurojnë akses për personat me dëgjim të dëmtuar, përmes sigurimit të interpretuesit në gjuhën e shenjave, megjithatë, akoma nuk ekziston një model i unifikuar për zbatimin e këtij shërbimi.

>>> Koncepti i aksesit deri te informacionet nuk është i njohur sa duhet, madje edhe nuk zbatohet në mënyrë adekuate në punën e deritanishme të gjykatave.

## Rekomandime

Në përputhje me konkluzionet, të cilat burojnë nga hulumtimi dhe vizitat në terren, rezultuan rekomandimet, si vijojnë:

1. Të përmirësohen kushtet fizike, përkatësisht të merren në konsideratë standardet për hyrje-dalje gjatë rikonstruksionit dhe ndërtimit të objekteve të reja, në mënyrë që të njëjtit të jenë të aksesshëm për të gjithë qytetarët, përkatësisht t'i respektojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të rritet pavarësia e tyre dhe të përmirësohet cilësia e jetës së tyre;
2. Të përforcohet kapaciteti i kuadrit i cili punon në gjykata, përmes trajnimeve dhe mundësive të tjera për mësim dhe zhvillim, me qëllim që t'i identifikojnë dhe në mënyrë përkatëse t'u përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuara;
3. Të përmirësohet aksesit deri te informacionet për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që t'u mundësohet pavarësi më e madhe gjatë realizimit të të drejtave dhe nevojave themelore;
4. Të bëhen reforma në punën e gjykatave, me ç'rast do t'i marrin parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara në nivelin e krijimit të shërbimeve të reja dhe mbështetjes gjatë realizimit të tyre, dhe
5. Të vendoset një qasje e unifikuar dhe sistematike gjatë udhëheqjes së të dhënave statistikore në lidhje me aftësinë e kufizuara dhe aksesin deri te drejtësia.



## Shoqata Qendra për Strategji dhe Zhvillim PAKTIS | Analizë e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit<sup>8</sup>

### Konstatime kryesore

Nga analiza e detajuar, që u realizua në kuadër të Projektit “Analiza e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit”, u konstatua se implementimi i tij do të rezultojë me rrënimin e sistemit të deritanishëm të përgjithshëm juridik – penal. Në mënyrë plotësuese, nga kjo analizë rezultuan konstatimet dhe konkluzionet, si vijojnë:

>>> Ligji plotësisht e cenon parimin e individualizimit të dënimit. Me ekzistimin e kriterëve objektive ligjore, të kategorive horizontale dhe vertikale, gjyqtari nuk mund ta përcaktoj llojin e sanksionit dhe ta masë dënimin për të cilin konsideron se është përkatës për kryerësin e veprës penale dhe i cili do ta kënaq drejtësinë dhe qëllimet e ndëshkimit.

>>> Ky Ligj e cenon plotësisht të drejtën e gjyqtarit të garantuar me ligj që të vendos lirisht sipas bindjes së gjyqtarit.

>>> Mund të konstatohet se qëllimi, për shkak të të cilit u miratua unifikimi i politikës ndëshkuese, duhej të realizohej në kuadër të pushtetit gjyqësor, më saktësisht Gjykata Supreme e cila do të merrte qëndrime dhe mendime në lidhje me materien ndëshkuese juridike.

>>> Në asnjë rast matja e dënimit nuk mund t'i takoj kornizës së pushtit ligjvënës dhe ai përmes miratimit të ligjit të përcaktoj kufi fiks të cilët gjyqtari duhet vetëm t'i aplikoj. Aq më shumë që formimi dhe veprimi i Komisionit për unifikimin e politikës ndëshkuese, anëtarët e të cilit i zgjedh Kuvendi i R. të Maqedonisë, i cili do ta ndjek politikën ndëshkuese të gjykatave, ndërkaq ekzistimi i një trupi të këtillë është absurd gjatë ndarjes eksplicite të pushtetit konform Kushtetutës.

>>> Ky ligj e vë në pikëpyetje edhe rolin e gjyqtarit gjatë përcaktimit të drejtë të drejtësisë, duke e vënë gjyqtarin në pozitë vetëm ta shqiptoj atë që në tabelat dhe fletat e punës është parashikuar në bashkëngjitje të ligjit.

>>> Zbatimi konsekuent i ligjit çon deri në epilog jo logjik gjatë procesit të përcaktimit të drejtë të drejtësisë në kuptimin e përcaktimit të dënimeve më të rënda për vepra më të lehta penale dhe e kundërta.


>>> Nuk arrihet qëllimi themelor për unifikimin e politikës ndëshkuese.


>>> Ky ligj veçanërisht shkon në dëm të kryerësve të veprave më të lehta penale të cilët janë dënuar më shumë herë, si dhe nuk e zgjidh problemin e risocializimit të kryerësve të këtillë, të cilët në vend që të heqin dorë nga kriminaliteti i vogël të njëjtit dënohen me tre, katër vjet burgim, me ç'rast ekziston probabilitet i madh nga “infeksioni i burgut”.

>>> Ligji e stimulon pranimin e fajit, meqë në praktikë kryerësve të veprave më të rënda penale u shqiptohen dënime më të vogla efektive me burgim meqë ata të mësuar e pranojnë fajin dhe bëjnë ujdi me prokurorin publik për lartësinë e dënimit.

## Rekomandime

1. Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit doemos duhet të shfuqizohet, meqë i njëjti është në kundërshtim me: Kushtetutën e RM-së në pjesën e ndarjes së pushteteve; me KP dhe Ligjin për gjykata ku në mënyrë të qartë është bërë distinkcioni i kompetencave të gjykatave. Konsiderojmë se shfuqizimi i këtij Ligji duhet të bëhet sa më shpejtë që është e mundur, meqë i njëjti krijoi kaos në sistemin e përgjithshëm ndëshkues juridik.
2. Nevojiten ndryshime të domosdoshme të KP, sa më shpejtë që është e mundur, në pjesën e matjes së lartësisë së dënimit dhe zbutjes së dënimit dhe kthimit të sërishëm të parimit të individualizimit të dënimit sipas bindjes së lirë të gjyqtarit.
3. Është e domosdoshme të precizohen dispozitat në kuadër të KP që kanë të bëjnë me rrethanat lehtësuese dhe rënduese.
4. Nevojitet të bëhet revizion i përgjithshëm ndaj pjesës së veçantë të KP, sa i përket minimumit dhe maksimumit ligjor, meqë distanca midis tyre është shumë e madhe dhe lë hapësirë për manipulime.
5. Duhet të miratohen udhëzime ose instruksione të cilat duhet t'i zbatoj prokurori publik kur merret vesh për propozim-ujdinë me të akuzuarin, përkatësisht kur vendos për llojin e sanksionit dhe për lartësinë e dënimit.
6. Nevojitet që Gjykata Supreme ta marrë përsëri në duart e veta unifikimin e politikës ndëshkuese, por kësaj radhe përmes miratimit aktiv të qëndrimeve dhe opinionëve parimore.
7. Nevojitet edhe angazhimi i gjykatave të apelit, të cilat përmes publikimit të Buletineve do t'u ofronin instruksione gjykatave themelore të RM.





## Këshilli për parandalimin e delikuencës së të miturve – KPDM | Analizë e zbatimit të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit<sup>9</sup>

### Konstatimet dhe rekomandimet kryesore

Nga aktgjykimet e analizuar, hulumtuesit vendosën të veçojnë disa dukuri të identifikuara të cilat konsiderojnë se meritojnë, thënë me gjuhën aritmetikore, të veçohen para kllapave, me qëllim që të stimulojnë analiza, hulumtime dhe interpretime të mëtutjeshme.

#### Tendenca të identifikuara

Nga të dhënat e fituara nga aktgjykimet e miratuara në periudhën e zbatimit të LPLLMLD, pa ndonjë analizë të thellë mund të vërehen dy tendenca evidente:

>>>pranimi i shpeshtuar i fajit në seancën kryesore (analiza e aktgjykimeve tregoi se thuaja se 90% e aktgjykimeve të miratuara sipas LPLLMLD të akuzuarit në seancën kryesore e kanë pranuar fajin); dhe

>>>zbatimi i shpeshtuar i procedurave për lëshimin e urdhër ndëshkimit, me ç'rast prokurorët dhe gjyqtarët e lehtësojnë punën e tyre pa i pikëzuar rrethanat e rastit konkret.

Në këtë mënyrë, dhe me zbatimin e LPLLMLD, gjyqtarët shqiptojnë sanksione të ngjashme si edhe para miratimit të këtij ligji. Ky është modusi i vetëm që i akuzuari të mos dëmtohet me dënim të matur dhe tepër të rreptë. Tendencat e këtilla, sipas hulumtuesve, mund të interpretohen si modus praktik se si të matet sanksioni i cili, në masë të konsiderueshme, nuk do të jetë i padrejtë ndaj të akuzuarit dhe në rastin konkret në përputhje me rrethanat.

#### Ndikimi i LPLLMLD lidhur me matjen e sanksioneve

Edhe pse nga 150 aktgjykimet e analizuar nuk mund të nxirren konkluzione përfundimtare, në lidhje me efektin e LPLLMLD mbi matjen e dënimeve, megjithatë hulumtuesit vendosën të theksojnë disa shembuj për matjen e dënimit me zbatimin e LPLLMLD ku në vend që të theksohet individualizimi, vërehet shabllonizimi në lidhje me atë se cilat rrethana kanë mbizotëruar sipas pikëzimit:

>>>për veprën penale Vjedhje nga neni 235 paragrafi 1, është përcaktuar dënim me para ose dënim me burgim deri në 3 vjet, për shkak të dënimit paraprak (kategoria e katërt) është shqiptuar dënim me burgim prej 2 vjetësh dhe 2 muajsh (24 muaj), vetëm për shkak të faktit se kanë mbizotëruar rrethanat rënduese;

>>>për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 236 paragrafi 1 pika 3, është përcaktuar dënim me burgim prej 3 deri në 10 vjet, paraprakisht i dënuar (kategoria e pestë), në vend të dënimit me burgim prej 3 vitesh (sipas tabelave të LPLLMLD) gjykata i ka matur gjysmën – e dënimit me burgim prej 1 viti e 6 muajsh duke e pasur parasysh se kanë mbizotëruar rrethanat lehtësuese, si dhe rrethanat se procedura është zhvilluar sipas propozim akuzës, ndërsa të akuzuarit, prokuroria fare nuk i ka ofruar mundësi për ujudi para paraqitjes së propozim akuzës;

>>>për një veprë penale të vazhduar Vjedhje nga neni 235 paragrafi 1 në lidhje me nenin 45 të KP, është përcaktuar dënim në para ose dënim me burgim deri në 3 vjet, për shkak të dënimit paraprak (kategoria e gjashtë) është shqiptuar dënim maksimal me burgim prej 3 vitesh, meqë kanë mbizotëruar rrethana rënduese;

<sup>9</sup> [http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Analiza\\_Primena-na-ZOVOVK\\_SPPMD-Juni-2017.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Analiza_Primena-na-ZOVOVK_SPPMD-Juni-2017.pdf)



>>>për dy vepra penale, Vjedhje me dhunë/armë nga neni 238 paragrafi 4 dhe Përpunimi i palejuar i armëve nga neni 396 paragrafi 1, për shkak të dënimit paraprak (kategoria e gjashtë), për veprën e parë është përcaktuar dënim me burgim prej 218 muajsh, ndërsa për veprën e dytë penale është përcaktuar dënim me burgim prej 110 muajsh, kështu që konform nenit 44 nga KP është matur dënimi i vetëm për vepra në bashkëveprim prej 14 vitesh burg edhe atë për shkak të pranimit të fajit, përkatësisht dënimi i është reduktuar për 30% nëse i akuzuari nuk e pranonte fajin për veprat e kryera;

>>>për veprën penale Lëndim trupor nga neni 130 paragrafi 2, pa dënim paraprak, i akuzuari është dënuar me burgim prej 15 muajsh;

>>>për dy vepra penale Mashtrim nga neni 247 paragrafi 1 për të cilin është përcaktuar dënim me para ose burgim deri në 3 vjet për shkak të më shumë dënimeve paraprake dhe faktit që kanë mbizotëruar rrethana rënduese, ndërkaq duke e pasur parasysh pranimin e fajit në seancën kryesore, për çdo vepër penale të akuzuarit i është përcaktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh, kështu që i është shqiptuar dënimi i vetëm me burgim prej 3 vitesh e 6 muajsh;

>>>për veprën penale Vrasje nga neni 123 paragrafi 2 pika 2, të akuzuarit i cili paraprakisht nuk ka qenë i dënuar dhe i cili e ka pranuar fajin në seancën kryesore, me 1 pikë rrethana rënduese dhe 14 pikë rrethana lehtësuese, i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 vitesh.

## A realizohet qëllimi i LPLLMLD?

Miratimi i LPLLMLD kishte për qëllim ta unifikoj mënyrën e veprimit të gjyqtarëve gjatë matjes së dënimeve përmes rrethanave të përcaktuara lehtësuese dhe rënduese që duhet të vlerësohen. Gjatë analizës së aktgjykimeve, hulumtuesit identifikuan dy aspekte të cilat meritojnë të veçohen në mënyrë të posaçme:

## Shembuj të praktikës së paunifikuar përmes zbatimit të LPLLMLD

Analiza e aktgjykimeve tregoi se nuk janë të panjohura rastet kur për vepër të njëjtë penale në gjykata të ndryshme maten sanksione të ndryshme edhe pse zbatohet LPLLMLD:

>>>për veprën penale Lëndim trupor nga neni 130 paragrafi 2 në njërin nga gjykatat e analizuara me pranimin e fajit në seancën kryesore, paraprakisht i padënuar, është shqiptuar masë alternative – dënim me kusht (dënim i përcaktuar me burg prej 6 muajsh me periudhë kontrolli prej 1 viti); në një gjykatë tjetër për veprën e njëjtë penale, pa dënim paraprak, është shqiptuar dënim me burgim prej 15 muajsh;

>>>për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullit të drogave dehëse, substancave psikotrope dhe prekursorëve me sasi më të vogël nga neni 215 paragrafi 2 të KP, ndaj kryerësit primar, në një gjykatë është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajsh, ndërsa në një gjykatë tjetër është shqiptuar masa alternative – dënim me kusht (dënim i përcaktuar me burg prej 10 muajsh me periudhë kontrolli prej 2 vitesh).

## Shembuj të politikës së rreptë ndëshkuese

Apostrofimi i dënimit paraprak rezultoi me politikë ndëshkuese dukshëm më të rreptë me zbatimin e LPLLMLD:

>>>para zbatimit të LPLLMLD për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 131 paragrafi 1 është shqiptuar masë alternative – dënim me kusht me dënim të përcaktuar me burgim prej 6 muajsh me periudhë kontrolli prej 18 muajsh, ndërsa pas miratimit dhe zbatimit të LPLLMLD të akuzuarit i cili ka qenë kryerës primar dhe e ka pranuar fajin në seancën kryesore, i është shqiptuar dënim me burgim prej 4 muajsh;

>>>para zbatimit të LPLLMLD për një vepër penale të vazhduar Vjedhje e rëndë nga neni 236 paragrafi 1 pika 1 në lidhje me nenin 45 të KP është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, ndërsa pas miratimit dhe zbatimit të LPLLMLD, për një vepër penale të vazhduar Vjedhje nga neni 235 paragrafi 1 në lidhje me nenin 45 të KP, për shkak të dënimit paraprak është shqiptuar dënim me burgim prej 3 vitesh;

>>>para zbatimit të LPLLMLD për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 236 paragrafi 5 të KP tre të akuzuarve, të cilët paraprakisht kanë qenë të dënuar për vepra të ngjashme penale, ndërkaq njëri ka qenë në Idrizovë në vuajtjen e dënimit me burgim, gjykata dy personave u ka shqiptuar nga 6 muaj dënim me burgim, ndërsa të akuzuarit i cili ka qenë në Idrizovë i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajsh, ndërsa pas zbatimit të LPLLMLD të akuzuarit i cili vetëm një herë paraprakisht ka qenë i dënuar i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muajsh;

>>>para zbatimit të LPLLMLD për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 236 paragrafi 1 pika 1 të KP, të akuzuarit i cili është dënuar disa herë i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, ndërsa pas zbatimit të LPLLMLD të akuzuarit i cili vetëm një herë paraprakisht ka qenë i dënuar i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 17 muajsh, dënim ky i cili në të vërtetë është zvogëluar për 30% për shkak të pranimit të fajit në seancën kryesore.


### Shembuj në të cilët sipas LPLLMLD është shqiptuar dënim më i lehtë

Nuk janë përjashtuar rastet kur me zbatimin e LPLLMLD matet lloji dhe lartësia e sanksionit penal i cili vlerësohet si tepër i butë në krahasim me politikën ndëshkuese paraprakisht të përcaktuar. Dy shembujt në vijim shërbejnë si argument sa i përket pohimit të këtillë:

>>>për veprën e kryer penale Dhunim nga neni 186 paragrafi 1 të KP i akuzuari është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej vetëm 4 vitesh, meqë paraprakisht nuk ka qenë i dënuar, ka qenë i martuar, me arsim të formuar dhe nuk është zhvilluar procedurë për vepër tjetër penale, i ka takuar kategorisë së parë vertikale sipas së cilës nuk mund të shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje më të gjatë se 50 muaj;

>>>për veprën e kryer penale Vrasje të shumëfishtë nga neni 123 paragrafi 3 të KP, i akuzuari i cili është kryerës primar i ka takuar kategorisë së parë vertikale, me çrast duke e marrë parasysh mungesën e më shumë rrethanave rënduese, i është shqiptuar dënim me burgim prej 11 vitesh në përputhje me vlerën e përcaktuar mesatare për kategorinë e parë vertikale, përkatësisht i është shqiptuar dënim me burgim prej 132 muajsh.

>>>sqarimet bëjnë përpjekje si ta përafrojnë përlogaritjen aritmetikore me drejtësinë gjatë matjes së sanksionit.





RRJETA

23

Projekti “Rrjeti 23+”  
është finansuar nga Bashkimi European.

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Norwegian Embassy  
Belgrade

Ky projekt është i kofinansuar nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze në Beograd .  
[www.norveska.org.rs](http://www.norveska.org.rs)

